



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2285/6 prot

Datë 17.09.2024

V E N D I M

Nr. 1269/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17.09.2024 me

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Besnik Meçi” PF në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.REF-11029-06-25-2024, me objekt “*Riparim dhe mirëmbajte automjetesh për nevoja të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural*”, me fond limit 12,032,633.30 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 12.07.2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Alstezo” SHA, me NIPT (J63208420N) dhe adresë: Lagjja “Kryengritja e Fierit”, Rruga “Aulona”, Fier.

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve të Përqendruara, me adresë: Rruga “Reshit Çollaku”, Godina nr.6/337, (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.

Subjekte të interesuar:

Operatori ekonomik “Besnik Meçi” PF, me NIPT (L12407012R) dhe adresë: Autostrada Tiranë – Durrës,

Km.5, godinë njëkatëse përballë QTU-së, Kashar, Tiranë.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 05.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 27.06.2024, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.REF-11029-06-25-2024, me objekt “*Riparim dhe mirëmbajta automjetesh për nevoja të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural*”, me fond limit 12,032,633.30 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 12.07.2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 31.07.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Vilnik Motors” SHPK	5,224,100 lekë, skualifikuar
2. “Besnik Meçi” PF	5,926,800 lekë, kualifikuar
3. “Servis Auto 2000” SHPK	6,254,520 lekë, skualifikuar
4. “AEE Service” SHPK	7,159,000 lekë, skualifikuar
5. “Alstezo” SHA	7,340,000 lekë, kualifikuar
6. “Auto Manoku Servis” SHPK	8,422,000 lekë, skualifikuar

II.3. Në datën 09.08.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE Publikimin e Njoftimit të Fituesit Paraparak, për procedurën së prokurimit.

II.4. Në datën 14.08.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik, ka administruar ankesën me nr. A/2024/4441, dhe nr. Protokolli 2285/2024, datë 14.08.2024, të operatorit ekonomik “Alstezo” SHA.

Nga shqyrtimi paraparak i ankesës të sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Besnik Meçi” PF. Konkretisht në ankesën e tij, operatori ekonomik ankimues pretendon:

“[...] E kundërshtojme kualifikimin e ofertave si dhe vendimin e AK për kualifikimin e ofertës së Besnik Meçi” person fizik; me argumentimin, si me poshte

I - Në Formularin përmbledhës të vetedeklarimit, Pjesa III, Kriteret e për zgjedhjes / Kualifikimit /

A: DEKLARATE Ky OE nuk ka deklaruar (plotësuar) si vijon:

- Nuk ka të deklaruar dokumentacionin përkatës me numrin e punonjësve të nevojshme për ekzekutimin e kontratës sipas listës emergjente të tyre të specifikuar përkatësisht me profilin e punës që secili kryen (stafi teknik) në plotësim të kërkesës së vendosur nga AK në përmbushje të kriterit kualifikues të pikës 2.3.4 të Shtojcës 8 të DST,

- Nuk ka deklaruar dokumentacionin përkatës, pra nuk ka deklaruar në mënyrë të listuar me të dhënat konkrete mjetet dhe makineritë për zbatimin e kontratës, sepse nuk ka deklaruar me emertime të percaktuara konkretisht pajisjet që disponon realisht në servis të ushtrimit të aktivitetit.

Makineritë dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e kontratës nuk janë të deklaruara me emertesat përkatëse për të cilat ky OE pretendon që ka blerë (ose me qira) nëpërmjet faturave

te shitjes te paraqitura prane AK- se, nderkohe qe ky OE pretendon se i ka ne inventarin e asetëve te Shoqerise, per te permbushur kriterin kualifikues te pikes 2.3.5 te Shtojces 8 ne DT. II Oferta e OE Besnik Meçi p.f nuk ploteson kriterin kualifikues te Shtojces 8 – 'FORMULARI I KRITEREVE TE PERZGJEDHJES/ kualifikimit, te KRITERET E VECANTA TE KUALIFIKIMIT., Pika 2.3 Kapaciteti teknik, nenpika 4 , ne te cilin kerkohet:

2.3.4 operatorët ekonomike duhet te kete personelin teknik te nevojshem per realizimin e kontrates, ne perberje te cilit te kete te pakten 6 (gjashte) punonjes sipas profileve te meposhtme:

A) 1 (nje) pergjegjes Teknik, i cili duhet te jete Inxhinier mekanik ose Teknik, mekanik transporti.

B) 1 (nje) motorist,

C) 2 (dy) xhenerike,

D) 1 (nje) elektroauto,

E) 1 (nje) bojaxhi.

Ne lidhje me punonjesin ne piken (a), duhet te paraqitet:

- diploma e arsimit te larte dhe/ose deshmia e aftesise profesionale

- kontrate pune (te vlefshme) si pergjegjes Teknik, dhe te kete kohezgjatje jo me pak se afati i marreveshjes kuader.

Per secilin prej punonjesve ne pikat b, c, d, e me siper duhet te paraqitet:

- kontratat e punes, e vlefshme, ku te specifikohet pozicioni si motorist, xhenerik, elektroauto, bojaxhi dhe te kete kohezgjatje jo me pak se afati i marreveshjes kuader.

- deshmite e aftesise profesionale, per secilin punonjes, sipas Ligjit Nr.15/2017, mbi arsimin dhe formimin profesionale, i ndryshuar.

OE Besnik Meçi p.f nuk ploteson kriterin kualifikues lidhur me kerkesen per DESHMITE E AFTESISE PROFESIONALE PER SECILIN PUNONJES sipas PROFILEVE: motorrist, xhenerik, elektroaut, bojaxhi.

Sa me siper, AK ka kerkuar qe e OE duhet te kete personelin teknik te nevojshem per realizimin e kontrates, ne perberje te cilit te kete te pakten 6 (gjashte) punonjes sipas profileve : 1 (nje) pergjegjes Teknik, i cili duhet te jete Inxhinier mekanik ose Teknik, mekanik transporti. , 1 (nje) motorist, 2 (dy) xhenerike, 1 (nje) elektroauto dhe 1 (nje) bojaxhie... Dhe ne plotesim te ketij kriteri, per te vertetuar se punonjesit e mesiper jane te afte per te ushtruar profesionin e tyre ne profilet e kerkuara, duhet qe te paraqese deshmite e aftesise profesionale, per secilin punonjes, sipas Ligjit Nr.15/2017, mbi arsimin dhe formimin profesionale, i ndryshuar.

Konkretisht, meqenese operatori ekonomik Besnik Mece p.f eshte shpallur fitues nga ana e AK, atehere sipas parashikimeve te Nenit 26/6 te LPP-se, ne plotesim te ketij kriteri ky operator duhet qe te kete te pajisur punonjesit me deshmite e aftesise profesionale, per secilin punonjes, sipas Ligjit Nr.15/2017, embi arsimin dhe formimin profesionale, i ndryshuar...,te kerkuara nga AK dhe jo vetem, por duhet ti kete deklaruar perkatesisht me numrin e tyre dhe emrat respektiv, sipas profilit te punes qe ata kryejne, ne Shtojcen 9 te DT (kjo shtojce eshte dorezuar ne momentin e paraqitjes se ofertes).

Nga informacionet qe kemi nepermjet eksperiencave ne procedurat parardhese, rezulton qe ky Operator ka dorezuar prane AK-se , si me poshte:

- certifikate leshuar nga Instituti Profesional ATC, per z.O.D, i cili ka perfunduar kursin

Profesional per autoservise;

Certifikate leshuar nga Agjencia kombetare e punesimit dhe Aftesive, per z.E.B, i cili ka perfunduar kursin profesional per exhenerike;

- certifikate leshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Nr.4 tirane, per z.K.LL, i cili ka perfunduar kursin profesional per mekanik automjetesh;

- diplome Profesionale ne teknologji automjetesh leshuar nga Kolegji Profesional i tiranes, per z.A.K;

- certifikate leshuar nga Instituti Profesional ATC, per z.K.P, i cili ka perfunduar kursin profesional per autoservise,

Sa me siper, konstatohet se dokumentet e paraqitura per punonjesit nga ana e OE Besnik Meçi pf, NUK jane sipas kerkesave te bere nga AK, pasi sikurse duket me siper keta punonjes NUK jane te pajisur me deshmite e aftesise profesionale, sipas profileve te kerkuara nga AK per secilin punonjes, sipas Ligjit Nr.15/2017, mbi arsimin dhe formimin profesional, i ndryshuar. Si nje nga profesionistet me me shume eksperience ne fushen e riparimit te automjeteve, si dhe duke u referuar Ligjit per Arsimin Profesional, sqarojme edhe njehere qe Certifikatat e paraqitura nga ky OE, konkretisht: teknologji automjetesh, mekanik automjetesh apo e Autoservise, jane certifikata qe percaktojne drejtimin e pergjithshem, por jo PROFILIN qe shpreh ne menyre te specifikuar profesionale edhe kompetencat profesionale per te cilen eshte trajnuar (pergatitur) dhe eshte i afte te kryeje punonjesi.

Puna konkrete qe kryhet ne nje autoservis automjetesh eshte e ndare ne profile te vecanta te ushtrimit te aktivitetit per sherbim dhe riparim te automjeteit, sikurse jane profilet : motorrist, elektroaut, pompist, xhenerik, llamarinist, saldator, stukator llamarine, bojaxhi, axhustator, riparues turbinash, gomist, tapicerist...etj.

Sa me siper, pikerisht per kete arsye, jo pa qellim AK ka vendosur kerkesen :

- OE duhet te kete personelin teknik te nevojshem per realizimin e kontrates, ne perberje te cilit te kete te pakten 6 (gjashte) punonjes sipas profileve : 1 (nje) pergjegjes Teknik, i cili duhet te jete Inxhinier mekanik ose Teknik, mekanik transporti. , 1 (nje) motorist, 2 (dy) xhenerike, 1 (nje) elektroauto dhe 1 (nje) bojaxhie... Dhe ne plotesim te ketij kriteri nga ana e AK kerkohen pikerisht:

- kontratat e punes, e vlefshme, ku te specifikohet pozicioni si motorist, xhenerik, elektroauto, bojaxhi dhe te kete kohezgjatje jo me pak se afati i marreveshjes kuader.

- deshmite e aftesise profesionale, per secilin punonjes, sipas Ligjit Nr.15/2017, mbi arsimin dhe formimin profesional, i ndryshuar.

DESHMITE PROFESIONALE te kerkuara nga AK ne plotesim te ketij kriteri per Çdo punonjes, leshohen ne menyre te specifikuar ne perputhje me programet e aprovuara lidhur me aftesite profesionale qe perfitohen perkatesisht per Çdo punonjes sipas PROFILIT TE PUNES qe ata duhet te kryejne dhe qe jane te percaktuara qarte ne Kornizen Shqiptare te Kualifikimit,

Sipas dokumenteve te paraqitura, rezulton qe ky operator ekonomik nuk ka ne staf 1 (nje) motorrist te diplomuar ose te pajisur me Çertifikate kualifikimi per motorrist ne perputhje me Ligjin per Arsimin dhe Formimin Profesional (Ligji Nr. 15/2017 per arsimin dhe formimin profesional ne republiken e shqiperise) pasi kompania qe ka leshuar diplomen apo Certifikaten

nuk e ka te profilizuar punonjesin lidhur me kursin e formimit profesional ne specialitetin emotorriste, sikurse kerkohet ne Piken 2.3.4 ne Shtojcen 8 te DT.

Sipas dokumenteve te paraqitura, rezulton, qe ky operator ekonomik nuk ka ne staf 2 (dy) xhenerike te diplomuar ose te pajisur me Certifikate kualifikimi per xhenerike ne perputhje me Ligjin per Arsimin dhe Formimin Profesional (Ligji Nr. 15/2017 per arsimin dhe formimin profesional ne republiken e shqiperisee) pasi kompania qe ka leshuar diplomen apo Certifikaten nuk i ka te profilizuar te dy punonjesit lidhur me kursin e formimit profesional ne specialitetin xhenerike (sikurse kerkohet ne Piken 2.3.4 ne Shtojcen 8 te DT) por vetem njerin prej tyre.

Sipas dokumenteve te paraqitura, rezulton qe ky operator ekonomik nuk ka ne staf 1 (nje) elektroauto te diplomuar ose te pajisur me Certifikate kualifikimi per elektroauto ne perputhje me Ligjin per Arsimin dhe Formimin Profesional (Ligji Nr. 15/2017 per arsimin dhe formimin profesional ne republiken e shqiperisee) pasi kompania qe ka leshuar diplomen apo Certifikaten nuk e ka te profilizuar punonjesin lidhur me kursin e formimit profesional ne specialitetin elektroauto, sikurse kerkohet ne Piken 2.3.4 ne Shtojcen 8 te DT.

Sipas dokumentave te paraqitura, rezulton qe ky operator ekonomik nuk ka ne staf, 1 (nje) BOJAXHI te diplomuar ose te pajisur me Certifikate kualifikimi per bojaxhie ne perputhje me Ligjin per Arsimin dhe Formimin Profesional (Ligji Nr. 15/2017 eper arsimin dhe formimin Profesional ne republiken e shqiperisee) pasi kompania qe ka leshuar diplomen apo Certifikaten nuk e ka te profilizuar punonjesin lidhur me kursin e formimit profesional ne specialitetin bojaxhie, sikurse kerkohet ne Piken 2.3.4 ne Shtojcen 8 te DT.

Dokumentacioni i paraqitur per punonjesit e OE Besnik Meçi p.f, NUK eshte sipas kerkeses se paraqitur nga AK , pra nuk eshte ne perputhje me Ligjin per Arsimin dhe Formimin Profesional, sikurse kerkohet ne menyre te SPECIFIKUAR nga AK, pasi nga dokumentet e paraqitura nga ky OE konfirmohet qarte qe punonjesit e paraqitur NUK jane ne profilet perkatesisht : 1 (nje) motorrist; 2 (dy) xhenerik; 1 (nje) elektroauto dhe 1 (nje) bojaxhi, por kane certifikata te karakterit te cilat percaktojne drejtimin e pergjithshem, por qe ne asnje rast nuk garantojne zbatimin e kontrates.

OE Besnik Meçi p.f nuk ploteson kriterin kualifikues lidhur me kerkesen per per KONTRATAT E PUNES PER SECILIN PUNONJES

Ne DT, ne Shtojcen 8, nga AK ne plotesim te pikes 2.3.4 eshte kerkuar:

Per secilin prej punonjesve ne pikat b, c, d, e me siper duhet te paraqitet:

- kontratat e punes, e vlefshme, ku te specifikohet pozicioni si motorist, xhenerik, elektroauto, bojaxhi dhe te kete kohezgjatje jo me pak se afati i marreveshjes kuader.

Kontratat e punes, te paraqitura nga OE Besnik Meçi pf, nuk jane te vlefshme, pasi ne to NUK eshte specifikuar respektivisht ne Çdo rast per punonjesin profili i punes qe kerkohet te ushtrohet ne profesionin perkatesisht ne pozicionin si motorist, xhenerik, elektroauto apo bojaxhie dhe keto kontrata NUK kane ekohezgjatje jo me pak se afati i marreveshjes kuader sikurse kerkohet ne Piken 2.3.4 ne shtojcen 8 te DT nga AK

III - Oferta e Besnik Meçi p.f nuk ploteson kriterin kualifikues te pikes 2.3.5 te Shtojces 8 Konkretisht, ne DT, ne Shtojcen 8 - eformulari I KRITEREVE TE PERZGJEDHJES/ kualifikimit, tek KRITERET E VE«ANTA TE KUALIFIKIMIT., Pika 2.3 Kapaciteti teknik, Nenpika 5 kerkohet :

2.3.5 operatorët ekonomikë duhet të disponojnë pajisje dhe instrumente të nevojshme për zbatimin e kontratës, si vijon:

A) pajisje për kontrollin dhe realizimin e gjeometrisë (konvergjencës) së rrotave të mjetit, të pakten 1 (një) copë;

B) pajisje bango prove, për motorrre dhe alternator (dinamo);

C) pajisje diagnostikuese, të defekteve elektronike në mjete, të pakten 1 (një) copë;

D) pajisje për kontrollin dhe furnizimin e gazit të A/C;

E) Pajisje për kontrollin dhe testimin e sistemit të frenimit të automjetit.

F) pajisje të levizshme (portabile) për ndezje emergjente të mjetit 12v & 24v;

G) pajisje ure ngritëse për automjetet, të pakten 3 (tre) ura për mjetet objekt prokurimi.

H) pajisje për kontrollin në presion të difektimit të cilindrave dhe testatave të motorrit;

I) pajisje për kontrollin në presion të difektimit të sistemit të ftohjes;

J) pajisje për zëvendësimin e vajit të motorrit;

K) pajisje për zmontimin dhe montimin e gomave në diskun e gomës të mjetit;

L) pajisje për kontrollin & balancimin e disqeve & gomave në mjet.

Për të vertetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet: dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mesiperme, që vertetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontrate dhurimi / Çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Në këtë kriter Autoriteti Kontraktor (AK) ka kërkuar që ofertuesi të disponojë në ambientet e punës së tij pajisje dhe instrumenta për realizimin e kontratës që prokurohet, ku ndër të tjera kerkohen dhe këto pajisje, si vijon: : e) pajisje bango prove, për motorrre dhe alternator (dinamo); h) pajisje për kontrollin në presion të difektimit të cilindrave dhe testatave të motorrit; i) pajisje për kontrollin në presion të difektimit të sistemit të ftohjes; l) pajisje për kontrollin & balancimin e disqeve & gomave në mjet.e

Për më tepër, AK ka kërkuar që ofertuesi për të vertetuar se i disponon këto pajisje duhet të paraqesë njerin prej dokumentave të mëposhtem:

- fatura blerje ose

- dokumente zhdoganimi ose

- kontrata qiraje ose

- kontrata huapërdorje ose

- kontrate dhurimi ose

- Çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Nga informacioni që në kemi nëpërmjet eksperiencave të mëparshme, rezulton që nga ana OE Besnik Meçi p.f, në plotësim të kësaj pike janë dorëzuar dokumentet e mëposhtme: fature tatimore shitje nr. 059, date 12.04.2019; fature tatimore nr. 12/2021, date 02.09.2021; fature tatimore nr.12/2022, date 14.02.2022; fature tatimore nr.188, date 11.08.2017; fature tatimore nr.226161201, date 25.06.2018; fature tatimore nr.275, date 16.11.2018; fature tatimore nr.159, date 26.09.2018, ku konstatohet se pajisjet e kërkuara janë blerë nga operatori ekonomik ofertues Besnik Meçi P.F.

Duke marr shkas nga keto dokumentacione te dorezuara, theksojme se blerja e pajisjeve nga ky OE ne vitet paraardhese: 2017, 2018, 2021 dhe 2022 , nuk verteton qe ky OE i ka gjendje aktualisht keto pajisje. Per kete arsye kerkojme nga ana e AK te behet verifikim sa i perket disponibilitetit te pajisjeve te kerkuara ne Piken 2.3.5 te Shtojces 8 ne DT. Ne kete rast, mjafton qe te behet verifikimi ne bilancin vjetor te vitit te fundit te aktivitetit, ne fagen e tatimeve, ku Çdo OE duhet te dorezoje edhe inventarin e mjeteve kryesore te listuar me emertesat perkatese, ku ne te duhet te jene te pasqyruara edhe pajisjet e blera (ose me qira) ne vitet paraardhese sikurse OE pretendon qe disponon.

Gjithashtu, ne kushtet aktuale, makinerite dhe pajisjet qe te vertetohet prezenca e tyre, ato duhet te jene te pasqyruara ne rregjistrin e aseteve, pasi mundet qe te gjitha pajisje (ose njera prej tyre) mund te jete e rishitur ose dale jashte perdorimit dhe nuk ka asnje vlere per rastin ne fjale.

Pervec sa me siper, ky OE NUK ka deklaruar dokumentacionin perkates, pra NUK ka deklaruar ne menyre te listuar me te dhenat konkrete mjetet dhe makinerite sa me siper per zbatimin e kontrates ne Formularin permbledhes te vetedeklarimit, sikurse kerkohet ne Shtojcen 9 te DT. .. Pasi ky OE

NUK ka deklaruar ne kete Formular me emertime te percaktuara konkretisht pajisjet qe disponon realisht ne servisin ku ushtron aktivitetin.

Kerkojme nga ana e AK te beje verifikimin e metejshem te dokumentacionit perkates qe verteton disponibilitetin ne perputhje me kontrollin fizik, ne vend, aty ku pretendohet se keto pajisje jane ne dispozicion, apo jane te montuar ne autoservisin e OE.

Nisur nga argumentimet dhe arsyetimi i mesiper, konkludojme qe kjo kompani nuk disponon Ne ambientin e punes se saj pajisjet:

b) pajisje bango prove, per motorrine dhe alternator (dinamo); h) pajisje per kontrollin ne presion te difektimit te cilindrave dhe testatave te motorrit; i) paisje per kontrollin ne presion te difektimit te sistemit te ftohjes; l) paisje per kontrollin & balancimin e disqeve & gomave ne mjet.e gjithashtu dokumentacioni fizik i dorezuar prej tij nuk perputhet me deklarimet e bera prej tij ne Shtojcen 9 (te dorezuar prej tij) dhe se ky dokumentacion fizik nuk permbush kriterin kualifikues te pikes 2.3.5, persa i perket disponimit te ketyre pajisjeve.

Perfundimisht, klasifikimi i ofertes se OE Besnik Meçi pf eshte bere ne kundertshtim me Ligjin Nr.162/2020, dt.23/12/2020 eper PROKURIMIN PUBLIK, Neni 82 si edhe V.K.M. Nr. 285, date 19.05.2021 per MIRATIMIN E RREGULLAVE TE PROKURIMIT PUBLIK, i ndryshuar, si dhe nuk ploteson KRITERET E VEÇANTA TE KUALIFIKIMIT te vendosura nga AK ne Shtojcen 8 te DT.”

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 2285/2 Prot., datë 15.08.2024, duke publikuar kriteret të cilat operatori ekonomik ankimues pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Besnik Meçi” PF, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Me shkresën nr. 510/9 prot, datë 23.08.2024, me objekt: “Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Alstezo” SHPK lidhur me vlerësimin e ofertave, në procedurën e prokurimit me nr. REF-11029-06-25-2024, me objekt “Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh për nevoja të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, protokolluar me tonën me nr. 2285/3 prot. datë 26.08.2024, autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion mbi procedurën e prokurimit, aktin e trajtimit të ankësës së operatorit ekonomik “Alstezo” SHA, ku konstatohet, se ankesa e këtij të fundit është refuzuar. Gjithashtu, autoriteti kontraktor ka dorëzuar bashkëlidhur informacionit të mësipërm, dokumentacionin fizik të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor nga operatori ekonomik “Besnik Meçi” PF.

II.7. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua, se nuk janë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 të “Ligjit për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Alstezo” SHA, mbi kundërshtimin e Vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Besnik Meçi” PF, në procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi me arsyen se nuk plotëson kriterin 2.3.4 të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit lidhur me punonjësit [...] Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.2. Në shtojcën 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.4 autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

2.3.4 *Operatorët ekonomikë duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës, në përbërje të cilit të ketë të pakten 6 (gjashtë) punonjës sipas profileve të mëposhtme:*

- a) **1 (një) përgjegjës Teknik, i cili duhet të jetë Inxhinier mekanik ose Teknik, mekanik transporti.**
- b) *1 (një) motorist,*
- c) *2 (dy) xhenerikë,*
- d) *1 (një) elektroauto,*
- e) *1 (një) bojaxhi.*

Në lidhje me punonjës në pikën (a), duhet të paraqitet:

- diploma e arsimit të lartë dhe/ose dëshmia e aftësisë profesionale
- kontratë pune (të vlefshme) si përgjegjës Teknik, dhe të ketë kohëzgjatje jo më pak se afati i marrëveshjes kuadër.

Për secilin prej punonjësve në pikat b, c, d, e më sipër duhet të paraqitet:

- kontratat e punës, e vlefshme, ku të specifikohet pozicioni si motorist, xhenerik, elektroauto, bojaxhi dhe të ketë kohëzgjatje jo më pak se afati i marrëveshjes kuadër.
- Dëshmitë e aftësisë profesionale, për secilin punonjës, sipas Ligjit Nr.15/2017, "Mbi arsimin dhe formimin profesional", i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT.

Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

III.1.3. Në shtojcën 9 "Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit" të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

Shtojca 9

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

- I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----

Telefoni:	-----
E-mail:	----- -

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT -i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.20 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të pl në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitim kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në ç aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në inte të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar n Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurren nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës p Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
 - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjet
 - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shu konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes a angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6.a) dhe 6.b), të përmendur më lart, nuk ka pa konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
 - a) çmimet;
 - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
 - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,

d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon: Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me

zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik". Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe gar: masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për gru rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspekti Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje lig operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara: ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike dhe termat e referencës, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e shërbimeve dhe grafikun e ekzekutimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
------------------	------------------

<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:</p> <p>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.</p>	<p><u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve:</p> <hr/> <p>Profili i punonjësve</p> <hr/> <p>– <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</p> <hr/>
<p>Emri, Mbiemri _____</p> <p>Firma _____</p> <p>Vula _____</p> <p>Data e dorëzimit të deklaratës _____</p>	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- *Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*
- *Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

III.1.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Besnik Meçi” PF, në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, i plotësuar, nga operatori ekonomik “Besnik Meçi” PF, ku ndër të tjera ka plotësuar në Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjet/Kualifikimit, B: Deklaratë Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen), si më poshtë:

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:	<u>Punonjës</u>
Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.	Po [x] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: 13 punonjës
	Profili i punonjësve Ing. Mekanik, Mekanik, Motorrist, Xhenerik, Elektroauto, Gomist, Shofer, Llamarinist-Bojaxhi, Magazinier. Etj...

III.1.5. Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet

kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohej operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.1.6. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të*

lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.1.7. Në ligjin Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 3 të tij përcakton se: “Arsimi dhe formimi profesional ka për mision: a) të zhvillojë kompetenca personale e profesionale të nevojshme, si dhe shprehi e kompetenca të tjera të diversifikuara, që pasqyrojnë preferencat dhe nevojat e veçanta të punëdhënësve për të siguruar mirëqenie sociale dhe zhvillimin ekonomik; b) të ofrojë arsim dhe formim profesional në përputhje me nivelin e zhvillimit të shkencës e të teknologjisë, me kërkesat e tregut të punës në ndryshim të vazhdueshëm, si dhe me kulturën e traditën kombëtare; c) të sigurojë përputhshmëri ndërkombëtare të dokumenteve certifikuese të lëshuara.”

Ndërsa në pikën 17 të nenit 4 të po këtij ligji thuhet se: “Certifikatat/dëshmitë/diplomat” janë dokumente zyrtare të llojeve të ndryshme, të lëshuara nga një organ certifikues, të cilat regjistrojnë arritjet e një individi pas vlerësimit, sipas një procedure e standardi të paracaktuar.

III.1.8. Në rastin konkret, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik vihet re, se në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Besnik Meçi” PF ka dorëzuar Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, i cili në zbatim të

parashikimeve ligjore në fuqi, autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevoje apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë.

Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni, konstatohet, se operatori ekonomik “*Besnik Meçi*” PF, në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në Pjesën III, B: Deklaratë Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme, në lidhje me punonjësit dhe pajisjet, ka deklaruar, se ka në stafin e tij punonjësit e kërkuar.

III.1.9. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, dokumentet e tenderit, si dhe informacioni dhe dokumentacioni i dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet, se operatori ekonomik “*Besnik Meçi*” PF, si operator ekonomik i kualifikuar i pari në këtë procedurë prokurimi, në zbatim të nenit 26, pika 6, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni, konstatohet, se operatori ekonomik “*Besnik Meçi*” PF, në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në Pjesën III, B: Deklaratë Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme, ka deklaruar stafin që disponon. Referuar pretendimeve të ankimuesit, konkretisht, operatori ekonomik “*Besnik Meçi*” PF ka deklaruar se disponon “**13 punonjës; Profili i punonjësve: Ing.Mekanik, Mekanik, Motorrist, Xhenerik, Elektroauto, Gomist, Shofer, Lllamarinist – Bojaxhi, Magazinier etj.**”

Konkretisht në pikën 2.3.4 të “Kritereve të Veçanta të Kualifikimit”, të dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar që: “*2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës, në përbërje të cilit të ketë të pakten 6 (gjashtë) punonjës sipas profileve të mëposhtme:*

a) 1 (një) përgjegjës Teknik, i cili duhet të jetë Inxhinier mekanik ose Teknik, mekanik transporti.

b) 1 (një) motorist,

c) 2 (dy) xhenerikë,

d) 1 (një) elektroauto,

e) 1 (një) bojaxhi.”

Në lidhje me punonjësën në pikën (a), duhet të paraqitet:

- diploma e arsimit të lartë dhe/ose dëshmia e aftësisë profesionale

- *kontratë pune (të vlefshme) si përgjegjës Teknik, dhe të ketë kohëzgjatje jo më pak se afati i marrëveshjes kuadër.*

Për secilin prej punonjësve në pikat b, c, d, e më sipër duhet të paraqitet:

- *kontratat e punës, e vlefshme, ku të specifikohet pozicioni si motorist, xhenerik, elektroauto, bojaxhi dhe të ketë kohëzgjatje jo më pak se afati i marrëveshjes kuadër.*

- *Dëshmitë e aftësisë profesionale, për secilin punonjës, sipas Ligjit Nr.15/2017, "Mbi arsimin dhe formimin profesional", i ndryshuar.*

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT.

Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Duke qenë se operatori ekonomik "Besnik Meçi" PF është kualifikuar i pari në procedurën e prokurimit, KPP në kuadër të shqyrtimit të ankesës së operaorit ekonomik ankimues, nëpërmjet shkresës nr. 510/9 prot, datë 23.08.2024, me objekt: "Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik "Alstezo" SHPK lidhur me vlerësimin e ofertave, në procedurën e prokurimit me nr. REF-11029-06-25-2024, me objekt "Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh për nevoja të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural", protokolluar me tonën me nr. 2285/3 prot. datë 26.08.2024, autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion mbi procedurën e prokurimit, dokumentacionin fizik të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor nga operatori ekonomik "Besnik Meçi" PF.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, si dhe nisur nga pretendimet e ankimuesit, konstatohet, se operatori ekonomik "Besnik Meçi" PF, në përmbushje të kriterit për punonjësit e mësipërm në dokumentet e tenderit, referuar deklarimeve të tij në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, për punonjësin **1 (një)** përgjegjës Teknik, i cili duhet të jetë Inxhinier **mekanik ose Teknik, mekanik transporti**, ka paraqitur Kontratë Individuale punësimi, datë 15.09.2023 midis punëdhënësit "Autoservis DBD Group/ Besnik Meçi" si Punëmarrësit Z. E.H, me detyrën "Ing Mekanik/Drejtues teknik", me afat 3 (tre vjecar), afat ky që fillon nga data 14.09.2023 me të drejtë rinovimi nëse palët bien dakort; Diplomë Nr.3252, në emër të E.H, në degën "Mekanike", i cili i jepet titulli "Inxhinier Mekanik", Drejtimi: Mjete Transporti, lëshuar nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike; Dëshmi Aftësie Profesionale për Përgjegjësin Teknik të Aktivitetit të Autoriparimit, lëshuar në emër të z.E.H, datë 23.07.2018, nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor;

Për punonjësin **d) 1 (një) elektroauto** ka paraqitur Kontratë pune, datë 06.09.2023, midis punëdhënësit "DBD Group/ Besnik Meçi" si dhe Punëmarrësit Z.Adiol Kambo, me detyrën "Elektroauto për automjete", me kohëzgjatje pa afat; Diplomë Profesionale në "Teknologji Automjetesh", në emër të z. A.K, për përfundimin me sukses të studimeve profesionale të larta, me kohë të plotë, lëshuar nga Kolegji Profesional i Tiranës.

Për punonjësin **2 (dy) xhenerikë** ka paraqitur Kontratë Individuale punësimi, datë 13.09.2021 midis punëdhënësit "Autoservis DBD Group/ Besnik Meçi" si dhe Punëmarrësit Z.K.L, me detyrën "Mekanik automjetesh/ Xhenerik", me afat 3 (tre vjecar), afat ky që fillon nga data 13.09.2021, me të drejtë rinovimi nëse palët bien dakort; Certifikatë për përfundimin e kursit

të formimit profesional për “Mekanik Automjetesh”, në emër të z. K.L, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Nr.4 Tiranë.

Gjithashtu, ka paraqitur Kontratë pune, datë 08.01.2024 midis punëdhënësit “DBD Group/ Besnik Meçi” si dhe Punëmarrësit Z. B.M, me detyrën “*Shërbim automjetesh – Xhenerik, Bojaxhi*”, me kohëzgjatje pa afat të përcaktuar; Dëshmi Kualifikimi për mbarimin e kursit “Shërbim Automobilashh”, në emër të z. B.M, Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Durrës.; Sikkens Certificate, Mr.B.M, of successfully attended the course “Sikkens Professional Spraying Techniques”, held in Zalec, Slovenia, 6-9.12.2022; AkzoNobel;

Për punonjës in **1 (një) motorist** ka paraqitur Kontratë pune, datë 26.01.2022 midis punëdhënësit “DBD Group/ Besnik Meçi” si dhe Punëmarrësit Z.O.D, me detyrën “*Mekanik - Motorrist*”, me kohëzgjatje pa afat të përcaktuar; Certifikatë për përfundimin e kursit profesional nëntëmujor për “Autoservis”, në emër të z. O.D, lëshuar nga Instituti Profesional ATC.

Për punonjës in **1 (një) bojaxhi** ka paraqitur Kontratë pune, datë 08.01.2024 midis punëdhënësit “DBD Group/ Besnik Meçi” si dhe Punëmarrësit Z.B.M, me detyrën “*Shërbim automjetesh – Xhenerik, Bojaxhi*”, me kohëzgjatje pa afat të përcaktuar; Dëshmi Kualifikimi për mbarimin e kursit “Shërbim Automobilashh”, në emër të z. B.M, Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Durrës; Sikkens Certificate, Mr.B.M, of successfully attended the course “Sikkens Professional Spraying Techniques”, held in Zalec, Slovenia, 6-9.12.2022; AkzoNobel;

III.1.10. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, së pari vlen të theksojmë se operatori ekonomik “Besnik Meçi” PF ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik Formularin Përmbledhës së Vetëdeklarimit, të plotësuar sipas Shtojcës 9, duke deklaruar numrin e punonjësve që disponin si dhe profilet e tyre në përputhje me kriterin 2.3.4 të kriterëve të veçanta të kualifikimit.

Së dyti, për sa i përket pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, lidhur me dokumentacionin e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor nga operatori ekonomik “Besnik Meçi” PF, lidhur me vlefshmërinë e kontratave të punës, afatet e tyre, si dhe certifikatat e formimit profesional, KPP gjykon se, operatori ekonomik “Besnik Meçi” PF, për punonjës it e kërkuar ka paraqitur dokumentacionin përkatës sipas të gjitha kërkesave të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, duke dorëzuar kontratat punës, si dhe për secilin prej tyre dëshmitë e kualifikimit, të lëshuara nga institucione shtetërore, si dhe institucione private të pajisura me licencën përkatëse. Kontretisht, ka paraqitur për drejtues in teknik z.E.H diplomë të arsimit të lartë, ku vërtetohet se disponon titullin “Inxhinier Mekanik”, Drejtimi: Mjete Transporti. Për punonjës it 2 *Xhenerik*, ka paraqitur Certifikatë profesionale, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Nr.4 Tiranë dhe Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Durrës, të dyja institucione shtetërore të formimit profesional.

Për punonjës in **1 (një) elektroauto** ka paraqitur Diplomë Profesionale në “Teknologji Automjetesh”, lëshuar nga Kolegji Profesional i Tiranës, i cili nga verifikimi rezulton në listën e institucioneve të akredituara nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë si i vetmi institucion në RSh që kontrollon dhe vlerëson cilësinë në arsimin e lartë.

1 (një) motorist ka paraqitur Certifikatë për përfundimin e kursit, lëshuar nga Instituti Profesional ATC, ku nga verifikimi në licencën e këtij subjekti rezulton i licensuar në ofrimin e disa kurseve të formimit profesional, ndër të cilat edhe “Autoservis”.

Për punonjës **1 (një) bojaxhi** ka paraqitur Dëshmi Kualifikimi për mbarimin e kursit “Shërbim Automobilah”, lëshuar nga, Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Durrës; si dhe certifikatë nga Sikkens, AkzoNobel, Slloveni.

Sa më sipër, nisur nga pretendimet e ankimuesit, KPP gjykon, se referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret, operatori ekonomik “Besnik Meçi” me dokumentacionin e paraqitur vërteton, se punonjësit e paraqitur prej tij, disponojnë kualifikimet përkatëse, të cilat janë në përmbushje të kërkesave të autoritetit kontraktor, si dhe i shërbejnë qëllimit të realizimit të kësaj procedure prokurimi.

Për sa i përket pretendimeve të ankimuesit lidhur me afatin e kontratave të punës, KPP gjykon se, nga verifikimi i kontratave të mësipërme, rezulton, se këto të fundit janë të gjitha të vlefshme në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit, si dhe përcaktojnë në dispozitat e tyre se mund të rinovohen në çdo kohë më pëlqimin dhe vullnetin e palëve.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në momentin e paraqitjes së ofertës, operatori ekonomik duhet të disponojë dokumentacionin e kërkuar nga autoriteti kontraktor, dokumentacion i cili plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në ligj. Fakti që afati i vlefshmërisë së kontratave të punës përfundon në një kohë më të shpejtë se përfudnimi i marrëveshjes kuadër, nuk duhet të penalizojë subjektin, duke i kufizuar atij të drejtën për të marrë pjesë dhe rrjedhimisht për t’u kualifikuar në procedurën e prokurimit, pasi ky i fundit në çdo moment mund të rinovojë kontratat me punonjësit e kërkuar. Është detyrim ligjor i autoritetit kontraktor të kërkojë gjatë periudhës së realizimit të kontratës, zbatimin e detyrimeve nga ana e operatorit ekonomik me të cilin është lidhur kontrata, siç përcaktohen në dokumentet e tenderit dhe në kontratë. Në rast se konstatohet mosrespektim i këtyre detyrimeve, autoriteti kontraktor duhet të veprojë në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik dhe Kodin Civil.

Për rrjedhojë, KPP gjykon, se dokumentacioni i dorëzuar nga operatori ekonomik në lidhje e kriterin për punonjësit, përmbush të gjitha kërkesat e autoritetit kontraktor: numrin e punonjësve, profilet e tyre, kualifikimet dhe dëshmitë profesionale, si dhe kontrata të punës të vlefshme.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Alstezo” SHA për skualifikimin e operatorit ekonomik “Besnik Meçi” PF, me pretendimin, se citojmë “Nga informacioni që ne kemi nepermjet eksperiencave të meparshme, rezulton që nga ana OE “besnik meçi” PF, në plotësim të kësaj pike janë dorëzuar dokumentet e mëposhtme: fature tatimore shitje nr..059, datë 12.04.2019; fature tatimore nr.12/2021, datë 02.09.2021; fature tatimore nr.12/2022, datë 14.02.2022; fature tatimore nr.188, datë 11.08.2017; fature tatimore nr.226161201, datë 25.06.2018; fature tatimore nr.275, datë 16.11.2018; fature tatimore nr.159, datë 26.09.2018, ku konstatohet se pajisjet e kerkuara janë blerë nga operatori ekonomik ofertues Besnik Meçi P.F.

Duke marrë shkas nga këto dokumentacione të dorëzuara, theksojmë se blerja e pajisjeve nga ky OE në vitet paraardhese: 2017, 2018, 2021 dhe 2022, nuk vërteton që ky OE i ka gjendje aktualisht këto pajisje. Për këtë arsye kërkojmë nga ana e AK të bëhet verifikim sa i përket disponibilitetit të pajisjeve të kerkuara në Piken 2.3.5 të Shtojcës 8 në DT. Në këtë rast, mjafton që të bëhet verifikimi në bilancin vjetor të vitit të fundit të aktivitetit, në faqen e tatimeve, ku çdo OE duhet të dorëzojë edhe inventarin e mjeteve kryesore të listuar me emertetat perkatese, ku në të duhet të jenë të pasqyruara edhe pajisjet e blera (ose me qira) në vitet paraardhese sikurse OE pretendon që disponon.

Gjithashtu, në kushtet aktuale, makinerite dhe pajisjet që të vërtetohet prezenca e tyre, ato duhet të jenë të pasqyruara në rregjistrin e asetëve, pasi mundet që të gjitha pajisjet (ose njëra prej tyre) mund të jete e rishitur ose dale jashtë përdorimit dhe nuk ka asnjë vlerë për rastin në fjale.

Perveç sa me sipër, ky OE NUK ka deklaruar dokumentacionin perkates, pra NUK ka deklaruar në mënyrë të listuar me të dhënat konkrete mjetet dhe makinerite sa me sipër për zbatimin e kontratës në Formularin përmbledhës të vetedeklarimit, sikurse kërkohet në Shtojcën 9 të DT. .. Pasi ky OE

NUK ka deklaruar në këtë Formular me emertime të përcaktuara konkretisht pajisjet që disponon realisht në servis të ushtron aktivitetin.

Kërkojmë nga ana e AK të bëjë verifikimin e metejshëm të dokumentacionit perkates që vërteton disponibilitetin në përputhje me kontrollin fizik, në vend, aty ku pretendohet se këto pajisje janë në dispozicion, apo janë të montuar në autoservis të OE.

Nisur nga argumentimet dhe arsyetimi i mësipërm, konkludojmë që kjo kompani nuk disponon në ambientin e punës së saj pajisjet:

Eb) pajisje bango prove, për motorrë dhe alternator (dinamo); h) pajisje për kontrollin në presion të difektimit të cilindrave dhe testatave të motorrit; i) pajisje për kontrollin në presion të difektimit të sistemit të ftohjes; l) pajisje për kontrollin & balancimin e disqeve & gomave në mjet. Gjithashtu dokumentacioni fizik i dorëzuar prej tij nuk përputhet me deklaratimet e bera prej tij në Shtojcën 9 (të dorëzuar prej tij) dhe se ky dokumentacion fizik nuk përmbush kriterin kualifikues të pikës 2.3.5, për sa i përket disponimit të këtyre pajisjeve..[...]", Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se,

III.2.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.5 autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë pajisje dhe instrumente të nevojshme për zbatimin e kontratës, si vijon:

- a) pajisje për kontrollin dhe realizimin e gjeometrisë (konvergences) së rrotave të mjetit, të paktën 1(një) copë;
- b) pajisje bango provë, për motorrinë dhe alternator (dinamo);
- c) pajisje diagnostikuese, të difekteve elektronike në mjete, të paktën 1 (një) copë;
- d) pajisje për kontrollin dhe furnizimin e gazit të A/C;
- e) Pajisje për kontrollin dhe testimin e sistemit të frenimit të automjetit.
- f) pajisje të lëvizshme (portabile) për ndezje emergjente të mjetit 12v & 24v;
- g) pajisje urë ngritese për automjetet, të paktën 3 (tre) ura për mjetet objekt prokurimi.
- h) pajisje për kontrollin në presion të difektimit të cilindrave dhe testatave të motorrit;
- i) pajisje për kontrollin në presion të difektimit të sistemit të ftohjes;
- j) pajisje për zëvendësimin e vajit të motorrit;
- k) pajisje për zmontimin dhe montimin e gomave në diskun e gomës të mjetit;
- l) pajisje për kontrollin & balancimin e disqeve & gomave në mjet.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

III.2.2. Në shtojcën 9 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, përcaktohet si më poshtë:

Shtojca 9

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

II. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

B. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- -

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT-i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: _____ _____ etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.20 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të pl në çdo aspekt:

10. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
11. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitim kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në ç aspekt;
12. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në inte të Ofertuesit;
13. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar n Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
14. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurren nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - c) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - d) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës p Ofertë.

15. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):

- a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
□
- b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit). □

16. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6.a) dhe 6.b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:

- e) çmimet;
f) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
g) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
h) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

17. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).

18. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:
Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion

publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik". Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe gar: masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për gru rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspekt Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje lig operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara: ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata

Përgjigje

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike dhe termat e referencës, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e shërbimeve dhe grafikun e ekzekutimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [] Jo []
---	---------------

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: <hr/> Profili i punonjësve <hr/> <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: <hr/>
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.
- Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

III.2.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Besnik Meçi” PF, në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, i plotësuar, nga operatori ekonomik “Besnik Meçi” PF, ku ndër të tjera ka plotësuar në Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjet/Kualifikimit, B: Deklaratë Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen) si më poshtë:

<p><u>Makineri e mjete</u></p> <p>Po [x] Jo []</p> <p>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</p> <p>a) pajisje për kontrollin dhe realizimin e gjeometrisë (konvergences) së rrotave të mjetit, të paktën 1 (një) copë;</p> <p>b) pajisje bango provë, për motorrinë dhe alternator (dinamo);</p> <p>c) pajisje diagnostikuese, të difekteve elektronike në mjete, të paktën 1 (një) copë;</p> <p>d) pajisje për kontrollin dhe furnizimin e gazit të A/C;</p> <p>e) Pajisje për kontrollin dhe testimin e sistemit të frenimit të automjetit.</p> <p>f) pajisje të lëvizshme (portabile) për ndezje emergjente të mjetit 12v & 24v;</p> <p>g) pajisje urë ngritese për automjetet, të paktën 3 (tre) ura per mjetet objekt prokurimi.</p> <p>h) pajisje për kontrollin në presion të difektimit të cilindrave dhe testatave të motorrit;</p> <p>i) pajisje për kontrollin në presion të difektimit të sistemit të ftohjes;</p> <p>j) pajisje për zëvendësimin e vajit të motorrit;</p> <p>k) pajisje për zmontimin dhe montimin e gomave në diskun e gomës të mjetit;</p> <p>l) pajisje për kontrollin & balancimin e disqeve & gomave në mjet.</p> <p><u>Eti...</u></p> <p>Karrotrec ne dispozicion targa: AA501NS</p> <p>Ambientet e shërbimit te paisura me kamera sigure e sistem alarmi, vendndodhja e amabjenteve te ushtrimit te aktivitetit: 1.Autostrada Tr-Dr, km.5 Tiranë, 2. Rr. Durrësit, përball bllokut Gintash, Laprak. Tiranë.</p> <p><u>Të gjitha makinerit, mjetet dhe stafin e nevojshem per</u></p>

III.2.4. Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.2.5. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e)operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë)operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f)operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g)operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj)operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h)operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i)operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j)informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k)operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.2.6. Në rastin konkret, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik vihet re, se në përmbushje të kriterit të mësipërm operatori ekonomik “Besnik Meçi” PF ka dorëzuar Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, i cili në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevoje apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë.

Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni, konstatohet, se operatori ekonomik “Besnik Meçi” PF, në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në Pjesën III, B: Deklaratë Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme, në lidhje me pajisjet, ka deklaruar, se disponon pajisjet e kërkuara nga autoriteti kontraktor.

III.2.7. Lidhur me pretendimet e ankimuesit mbi dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik “Besnik Meçi” PF, në përmbushje të kriterit të kualifikimit lidhur me pajisjet e kërkuara, KPP nga verifikimi i pretendimeve të ankimuesit, vëren se këto pretendime, nuk lidhen drejtpërsëdrejti me përmbushjen ose jo të kërkesave të vendosura nga autoriteti kontraktor në kriteret e kualifikimit, por me pretendime apriori dhe hamendësime të operatorit ekonomik ankimues se këto pajisje nuk janë në disponim nga operatori ekonomik “Besnik Meçi” PF, për shkak të momentit të blerjes dhe disponimit të tyre (kërkesa këto të cilat nuk janë kushte kualifikimi).

III.2.8. Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale, duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshme të ankesës”, sipas përcaktimeve të nenit 48, “Kushtet formale të ankesës”, pika 3:

- *Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni”.*

Bazuar në sa më sipër, KPP gjykon, se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimuesi duhej të kishte shoqëruar pretendimet e tij me prova, indicie dhe argumente, në bazë të të cilave do të shqyrtohen këto pretendime. Vlen të ritheksojmë, se Komisioni i Prokurimit Publik është

organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 90 të LPP dhe nenit 80 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e autoritetit kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë, se cilat nga kërkesat e veçanta të kualifikimit lidhur me pajisjet, nuk përmbush operatori ekonomik “Besnik Meçi” PF. Një ankim, mbi hamendësime, pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjitha apo shumicën e elementeve përbërëse të dokumenteve të tenderit, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cenon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

KPP është paraparë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si i tillë në vendimmarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin, se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik, refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një ankim, i cili nuk mbështetet në asnjë argument.

Rrjedhimisht pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, nuk merren në shqyrtim.

III.3. Akoma më tej, referuar pretendimeve të ankimuesit, konkretisht “Nga informacioni që ne kemi nepermjet eksperiencave të meparshme, rezulton që nga ana OE “Besnik Meçi” PF, ne plotësim të kesaj pike jane dorezuar dokumentet e meposhtme: fature tatimore shitje nr..059, date 12.04.2019; fature tatimore nr.12/2021, date 02.09.2021; fature tatimore nr.12/2022, date 14.02.2022; fature tatimore nr.188, date 11.08.2017; fature tatimore nr.226161201, date 25.06.2018; fature tatimore nr.275, date 16.11.2018; fature tatimore nr.159, date 26.09.2018, ku konstatohet se pajisjet e kerkuara jane blere nga operatori ekonomik ofertues Besnik Meçi P.F.”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se, ankimuesi në ankesën e tij ka cituar dokumentacionin e dorëzuar nga operatorit ekonomik “Besnik Meçi” PF, pranë autoritetit kontraktor, dokumentacion i cili përbën sekret tregtar dhe informacion konfidencial, në kuptim të nenit 16 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Në pikën 4 të nenit 16 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet, se “Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj ose në legjislacionin e brendshëm, në veçanti legjislacioni në fuqi për të drejtën e informimit, dhe pa cenuar detyrimet që lidhen me publikimin e kontratave të dhëna dhe me informimin e kandidatëve dhe ofertuesve sipas parashikimeve në këtë ligj, autoriteti ose enti kontraktor nuk bën publike informacionet e dërguara nga operatorët ekonomikë, të cilët këta të fundit i kanë përcaktuar si konfidenciale, duke përfshirë, por pa u kufizuar me sekrete teknike ose tregtare dhe aspekte konfidenciale të ofertave”.

III.3.1. Sa më sipër, KPP konstaton, se fshehtësia e procesit të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, i parashikuar dhe nga *lex specialis*, shfaq një rëndësi të veçantë si në drejtim të mbrojtjes së nivelit më të lartë të interesit publik, por njëherazi shfaq edhe nivelin më të lartë të mbrojtjes së garancive procedurale të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në drejtim të

ruajtjes së sekretit tregtar, të dokumentacionit të dorëzuar nga këta të fundit në procedurat e prokurimit publik. Akoma më tej, KPP, gjykon, se cenimi i fshehtësisë së procesit të zhvilluar, për të cilin pjesëmarrësit në procedurat e prokurimit publik marrin dijëni në një formë të ndryshme nga ajo e caktuar në ligjin për prokurimin publik, mbi natyrën e kontratave të punësimit të stafit, llojit të tyre, listëpagesave të shoqërisë ku shfaqen të dhëna konfidenciale të punonjësit, numri i sigurimeve shoqërore, pagesa mujore (paga), lloji dhe natyra e kapaciteteve teknike të disponuara të konkurrentëve, cilësohet shkelje e sekretit tregtar të kompanive, pasi, përhapet informacion konfidencial i subjekteve tregtare të persona të paautorizuar, informacion i cili, jo vetëm i shkakton dëm interesave tregtare të shoqërive, por njëherazi cenon edhe procesin e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik.

III.3.2. Të ndodhur në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se shqyrtimi i çështjes së mësipërme është jashtë kompetencës lëndore të këtij të fundit. Referuar nenit 24/1 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij”. Sa më sipër, referuar materialeve të administruara në fashikullin e gjyqimit, Komisioni i Prokurimit Publik, në zbatim të nenit 23 të *lex specialis*, i propozon Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimit administrativ në lidhje me konstatimet e mësipërme.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Alstezo” SHA, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-11029-06-25-2024, me objekt “Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh për nevoja të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, me fond limit 12,032,633.30 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 12.07.2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

3. T'i propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimit administrativ për konstatimet e mësipërme, si edhe të dërgohet pranë APP-së kopje e ankimit elektronik nr. A/2024/4441, dhe nr. Protokolli 2285/2024, datë 14.08.2024.
4. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifave financiare të paguara nga operatori ekonomik “Alstezo” SHA.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaïd Myzyri